



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 1563/prot.  
3

Tiranë më 7.11.2018

**VENDIM**

Nr. 62, datë 7.11.2018

**MBI**

**ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", neneve 77-112 të Ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin*",

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit Nr. 263 datë 19.10.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Institucioni i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Peqin, me objekt:

- Verifikim i zbatimit të Rekomandimit Nr. 54 datë 26.12.2017, Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "*Institucioni i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale Peqin*".

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "*I.E.V.P. Peqin*", konstaton se:

1. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregullore "*Për mbrojtjen, përpunimin, dhe ruajtjen e të dhënave personale*", në zbatim të pikës së katërt të Rekomandimit Nr. 54/2017 të Komisionerit dhe nenit 27 të ligjit. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit Nr.9887/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", pika 2/1:

*"Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregulloret të tjera".*

2. Kontrolluesi "IEVP Peqin", nuk ka vendosur tabelat informuese me qëllim informimin e subjekteve, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (CCTV), në zbatim të pikës së tretë të Rekomandimit Nr.54/2017 të Komisionerit. Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi mbi përpunimin e të dhënave, është një detyrim ligjor i rëndësishëm për kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të ushtrojnë të drejtat ligjore që gëzojnë, në zbatim të Ligjit Nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit ka hartuar procesverbalin (datë 23.10.2018), të cilin përfaqësuesi i kontrolluesit e ka nënshkruar pa paraqitur pretendime.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", kontrolluesi "I.E.V.P. Peqin" është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore pranë ambjenteve të Zyrës së Komisionerit. Kontrolluesi është paraqitur në seancë dhe ka dokumentuar rikuperimin e shkeljeve administrative të konstatuara në kontrollin e ushtruar pranë tij.

Zyra e Komisionerit e vlerëson këtë qëndrim dhe reflektim të menjëhershëm, por kjo nuk e përjashton kontrolluesin nga përgjegjësia administrative. Shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar në vitin 2017 pranë kontrolluesit "I.E.V.P. Peqin", duhej të rikuperoheshin brenda afatit 30 ditor dhe për masat e marra, duhej të njoftohej me shkrim Zyra e Komisionerit, sipas pikës së gjashtë të Rekomandimit Nr. 54/2017.

Si përfundim shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në lidhje me mungesën e rregullore specifike "Për mbrojtjen, përpunimin, dhe ruajtjen e të dhënave personale", në kuptim të nenit 39, pika 1, gërma "dh" të Ligjit Nr. 9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë:

*"Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10.000 deri në 150.000 lekë"*

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parashysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 27, 29, 30, 39 pika 1 gërma "dh", si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale",

## V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "I.E.V.P. Peqin", me gjobë në vlerën 30.000 (tridhjetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
3. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 02.11.2018.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

